

**VENDIM**  
**Nr.173, datë 10.3.2010**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR  
MINISTRINË E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT,  
PËR NDËRHYRJET EMERGJENTE NË OBJEKTET E MBROJTJES NGA  
PËRMBYTJA DHE DIGAT E REZERVUARËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, zëri “Investime”, t’i shtohet fondi prej 229 000 000 (dyqind e njëzet e nëntë milionë) lekësh për ndërhyrjet emergjente në objektet e mbrojtjes nga përmbytja dhe digat e rezervuarëve, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**LISTA E OBJEKTEVE PËR NDËRHYRJET EMERGJENTE NË OBJEKTET E MBROJTJES  
NGA PËRMBYTJA DHE DIGAT E REZERVUARËVE**

| <b>Nr.</b> | <b>Emërtimi i objektit</b>                                                     | <b>Vlera në milionë lekë</b> | <b>Bordi i kullimit</b> |
|------------|--------------------------------------------------------------------------------|------------------------------|-------------------------|
|            | Objekte të mbrojtjes nga përmbytja                                             |                              |                         |
| 1          | Mbrojtje nga lumi Drin në Ashtë, Shkodër                                       | 6                            | Shkodër                 |
| 2          | Mbrojtje nga lumi Devoll në fshatin Vlashuk, Kuçovë                            | 15                           | Berat                   |
| 3          | Thellimi i shtratit të lumit Devoll (Ura e Maliqit), Korçë                     | 50                           | Korçë                   |
|            | Digat e rezervuarëve (rehabilitimi i shkarkuesve katastrofik dhe ujëlëshuesve) |                              |                         |
| 4          | Diga e rezervuarit Shqefen, Mat                                                | 9                            | Mat                     |
| 5          | Diga e rezervuarit Suhbull, Mat                                                | 9                            | Mat                     |
| 6          | Diga e rezervuarit Midhës, Mat                                                 | 3                            | Mat                     |
| 7          | Diga e rezervuarit Kurjan, Fier                                                | 2.5                          | Fier                    |
| 8          | Diga e rezervuarit Lumara 1+2, Fier                                            | 6                            | Fier                    |
| 9          | Diga e rezervuarit Turbullt, Fier                                              | 3                            | Fier                    |
| 10         | Diga e rezervuarit Zallher, Tiranë                                             | 5                            | Tiranë                  |
| 11         | Diga e rezervuarit Marikaj, Tiranë                                             | 2                            | Tiranë                  |
| 12         | Diga e rezervuarit Shtoder, Shkodër                                            | 5                            | Shkodër                 |
| 13         | Diga e rezervuarit Staraveckë, Berat                                           | 1.5                          | Berat                   |
| 14         | Diga e rezervuarit Rogu, Berat                                                 | 1.5                          | Berat                   |
| 15         | Diga e rezervuarit Allambrez, Berat                                            | 1.5                          | Berat                   |

|    |                                                  |            |             |
|----|--------------------------------------------------|------------|-------------|
| 16 | Diga e rezervuarit Slanicë, Berat                | 1.5        | Berat       |
| 17 | Diga e rezervuarit Duhanas, Berat                | 1.5        | Berat       |
| 18 | Diga e rezervuarit Kalivaç, Gjirokastrë          | 2.5        | Gjirokastrë |
| 19 | Diga e rezervuarit Komarit, Tepelenë             | 2.5        | Gjirokastrë |
| 20 | Diga e rezervuarit Helmës, Korçë                 | 6          | Korçë       |
| 21 | Diga e rezervuarit Spitallë 2, Durrës            | 1          | Durrës      |
| 22 | Diga e rezervuarit Shkallnur, Durrës             | 1          | Durrës      |
| 23 | Diga e rezervuarit Likesh, Durrës                | 1          | Durrës      |
| 24 | Diga e rezervuarit Çizmeli, Durrës               | 1          | Durrës      |
| 25 | Diga e rezervuarëve Memaj, Arapaj, Vrion, Durrës | 1          | Durrës      |
| 26 | Diga e rezervuarit Shishtavec, Kukës             | 5          | Kukës       |
| 27 | Diga e rezervuarit Pla, Kukës                    | 8          | Kukës       |
| 28 | Diga e rezervuarit Stropcke, Pogradec            | 2          | Pogradec    |
| 29 | Diga e rezervuarit Seferaj, Kavajë               | 8          | Kavajë      |
| 30 | Diga e rezervuarit Hajdaraj, Kavajë              | 1          | Kavajë      |
| 31 | Diga e rezervuarit Zhabjak, Kavajë               | 2          | Kavajë      |
| 32 | Diga e rezervuarit Beden, Kavajë                 | 2          | Kavajë      |
| 33 | Diga e rezervuarit Pekisht, Kavajë               | 1          | Kavajë      |
| 34 | Diga e rezervuarit Divjakë, Lushnjë              | 2.5        | Lushnjë     |
| 35 | Diga e rezervuarit Manasufaj, Lushnjë            | 3.5        | Lushnjë     |
| 36 | Diga e rezervuarit Spolate, Lushnjë              | 2          | Lushnjë     |
| 37 | Diga e rezervuarit Ardenicë, Lushnjë             | 2          | Lushnjë     |
| 38 | Diga e rezervuarit Fier-Seman, Lushnjë           | 2          | Lushnjë     |
| 39 | Diga e rezervuarit Dushk, Lushnjë                | 2.5        | Lushnjë     |
| 40 | Diga e rezervuarit Posnovisht, Elbasan           | 6          | Elbasan     |
| 41 | Diga e rezervuarit Plangaricë, Elbasan           | 1.5        | Elbasan     |
| 42 | Diga e rezervuarit Kashtë, Elbasan               | 2          | Elbasan     |
| 43 | Diga e rezervuarit Marinë, Elbasan               | 1.5        | Elbasan     |
| 44 | Diga e rezervuarit Rajc, Elbasan                 | 1          | Elbasan     |
| 45 | Diga e rezervuarit Zaranikë, Elbasan             | 5          | Elbasan     |
| 46 | Diga e rezervuarit Xherie, Elbasan               | 5          | Elbasan     |
| 47 | Diga e rezervuarit Harvala, Vlorë                | 1          | Vlorë       |
| 48 | Diga e rezervuarit Malaj 1+2, Lezhë              | 8          | Lezhë       |
| 49 | Diga e rezervuarit Trojza, Lezhë                 | 6          | Lezhë       |
| 50 | Diga e rezervuarit Perlat, Lezhë                 | 3          | Lezhë       |
| 51 | Diga e rezervuarit Kashnjet, Lezhë               | 2          | Lezhë       |
| 52 | Diga e rezervuarit Kallmet, Lezhë                | 2.5        | Lezhë       |
| 53 | Diga e rezervuarit Trashan, Lezhë                | 2          | Lezhë       |
|    | <b>Totali</b>                                    | <b>229</b> |             |